



A.nr.11/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.11/2026, të datës 08.01.2026, të parashtruar nga ankuesit M.M-H, F.L, K.M, B.XH dhe L.B, të cilët sipas autorizimit të përbashkët i përfaqëson ankuesja M.M-H, nga Gjilani, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.11/2026, e datë 08.01.2026, e parashtruar nga ankuesit M.M-H, F.L, K.M, B.XH, dhe L.B.

A r s y e t i m

Ankuesit M.M-H, F.L, K.M, B.XH. dhe L.B, (*tutje referuar ankuesit*), më datë 08.01.2026, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes të datës 24.12.2025 dhe mosveprimit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Inspektoratit Qendror të Punës lidhur me mos kompensimin e shtesës në pagë për kushte specifike të punës sipas nenit 6, paragrafi 2, nënpika 2.1 dhe 2.2 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati Qendror i Punës, ndërsa ky i fundit ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 27/2026 të datës 08.01.2026, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesën e ankuesve e datës 17.11.2025 e parashtruar tek Njësia e Burimeve Njerëzore të IQP; Përgjigjen e datës 24.12.2025 nga Menaxheri i Personelit; Kopjet e ID-së së ankuesve; Autorizimet; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.01.2026; Përgjigjen në ankesë e datës

16.01.2026; Akt Emërimet e datës 29.09.2025 të ankuesve; Emailin e datës 09.03.2023 nga F.K për H.N lidhur me tabelën e pozitave që duhet të përfitojnë shtesë; Emailin nga KSHKSP i datës 24.02.2023.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesi, konstatoi se ankesa **është e pabazuar**, sepse:

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton:

- Ankuesit që të gjithë janë të punësuar në Inspektoratin Qendror të Punës dhe atë ankuesja M.M-H sipas Akt Emërimit me numër protokoli 1932 të datës 29.09.2025, mbanë pozitën *Inspektore për Siguri dhe Shëndet në Punë*; ankuesi F.L. sipas Akt Emërimit me numër protokoli 1933 të datës 29.09.2025, mbanë pozitën *Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë*; ankuesi K.M, sipas Akt Emërimit me numër protokoli 1930 të datës 29.09.2025, mbanë pozitën *Inspektor për Marrëdhënie Pune*; ankuesi B.XH. sipas Akt Emërimit me numër protokoli 1935 të datës 29.09.2025, mbanë pozitën *Inspektor për Marrëdhënie Pune* dhe ankuesi L.B., sipas Akt Emërimit me numër protokoli 1937 të datës 29.09.2025, mbanë pozitën *Inspektor për Marrëdhënie Pune*.
- Ankuesit më datë 17.11.2025, kanë parashtruar kërkesë me numër protokoli 03-650, tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës, për njohje të shtesës për kushte specifike të punës, sipas nenit 6, paragrafi 2, nënpika 2.1 dhe 2.2 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.
- Menaxheri i Personelit i Inspektoratit Qendror të Punës, më datë 24.12.2025 ka njoftuar ankuesit se në muajin mars 2023 sipas kërkesës së komisionit për përfitim të shtesës për kushte specifike të punës e kemi dërguar listën me numrin e inspektorëve tek komisioni përkatës por nuk kemi marr ende përgjigje.

Pretendimet ankimore

Ankuesit kanë pashtuar ankesë kundër përgjigjes të datës 24.12.2025 dhe mosveprimit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Inspektoratit Qendror të Punës lidhur me mos kompensimin e shtesës në pagë për kushte specifike të punës sipas nenit 6 paragrafi 2, nënpika 2.1 dhe 2.2 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik. Pretendojnë se plotësojnë të gjitha kërkesat për kompensim të shtesës për shkak të rrezikshmërisë në punë. Kërkojnë që ankesa të aprovohet, ti njihet e drejta e shtesës për kushte specifike të punës, të obligohet Inspektorati Qendror i Punës të bëjë kompensimin e kësaj shtese nga themelimi i marrëdhënies së punës në këtë institucion e në vazhdimësi.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet e ngritura si në ankesë u referua Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publik, konkretisht:

-Nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12, ku përcaktohet: *1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.12. shtesë page apo shtesë - nënkupton komponentin e pagës që i shtohet pagës bazë dhe që synon të shpërblejë punën për kushte të vështira, sektorë apo specializime të veçanta*

dhe që nuk shpërblehet nga paga bazë. Shtesa e pagës mund të jetë e rregullt, kur përfitohet për çdo muaj apo e parregullt kur shpërblehet sipas rastit në bazë të këtij ligji.

- Nenit 22: 1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; **1.4. shtesa për kushte specifike të punës**; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale.

-Nenit 26: 1. Shtesa për kushte specifike të punës përfitohet nga zyrtaret/ët publik dhe të punësuarat/it e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. 2. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar. 3. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 4. Me rastin e krijimit të funksioneve, pozitave, apo emërtesat e reja sipas nenit 42 të këtij ligji, institucioni në të cilin krijohet pozita, kur e vlerëson se kësaj pozite duhet ti takoj shtesa për kushte specifike të punës, kërkon nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave pëlqimin për përfitim të kësaj shtese. 5. Pozitat përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushte specifike të punës, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga Qeveria pas propozimit nga ministria përgjegjëse për financa.

Në kuptim të nenit 26 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L196 për Pagat në Sektorin Publik, Qeveria ka miratuar Rregulloren (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, (në fuqi nga data 07.02.2023) më të cilin përcaktohet:

-Nenit 1 paragrafi 1: 1. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë kriteret, kushtet, rregullat, mënyrën e llogaritjes dhe procedurën për përfitimin e shtesave të mëposhtme për të punësuarit në sektorin publik: 1.1. shtesa e performancës; **1.2. shtesa e kushteve specifike të punës**; 1.3. shtesa për vëllimin e punës; 1.4. shtesa për punën pa orar të paracaktuar.

-Nenit 6 paragrafi 1, 2 dhe 3,: 1. Shtesa për kushte specifike të punës është shtesë mujore që përfitohet nga zyrtarët publik dhe të punësuarit e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë së shtuar në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. 2. Kategoria e pozitave që janë të ekspozuara ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë në mënyrë të shtuar jetën, për të përfituar këtë shtesë mujore, duhet të plotësojnë kriteret si në vijim: 2.1. hetimi në teren, ku për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës; 2.2. kryerja e detyrave në operacione të rrezikshme, të cilët për shkak të detyrës përballen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rrezikshmërinë e jetës gjatë punës. 3. Në secilën situatë, shtesa për kushte specifike të punës nuk mund të përfitohet nga nëpunësit në strukturat përgjegjëse për funksionet e brendshme administrative të institucioneve përkatëse.

-Nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 : 1. Secili institucion që vlerëson se ka zyrtarë publikë dhe të punësuar të tjerë që plotësojnë kriteret për të përfituar këtë shtesë dorëzon kërkesën për miratim të shtesës për pozitat përkatëse tek Komisioni sipas paragrafit 2 të këtij neni, me të dhënat si në vijim: 1.1. punësuarve në këtë pozitë; 1.2. përshkrimin e punës të të punësuarit; 1.3. arsyetimin e detajuar për përfitimin e shtesës; 1.4.

klasën dhe koeficientin. 2. Kërkesa sipas paragrafit 1, dorëzohet tek Komisioni i cili themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar....

Bazuar në kuadrin ligjor si më sipër, e në mbështetje të vlerësimit të provave materiale të çështjes rrjedhë se nuk gjejnë mbështetje ligjore pretendimet ankimore që Këshilli t'iu njeh të drejtën e ankuesve në shtesë për kushte specifike të punës dhe të detyroj organin punëdhënës për kompensim të shtesës në fjalë, mbi faktin se më asnjë provë nuk vërtetohet së Inspektorati Qendror i Punës ka përcjell kërkesën për njohje të kësaj shtese pranë organit kompetent gjegjësisht të Komisioni për Shtesa për Kushte të Tregut të Punë në Ministrinë e Financave, dhe po ashtu nuk ka rekomandim nga komisioni kompetent për njohje të shtesës për kushte specifike të punës dhe miratim të këtij rekomandimi nga Ministri i Financave.

Andaj, mbi këto rrethana refuzimi i ankesës i referohet vetëm gjendjes aktuale, mirëpo, Kolegji sjell në vëmendje faktin së Zyrtari Kryesor Administrativ i IQP mund të vlerësoj çështjen e shtesës për kushte specifike të punës lidhur me zyrtaret inspektues dhe nëse konsideron së plotësohet kushtet e përcaktuara ligjore atëherë mund të parashtroj kërkesë tek komisioni gjegjes sipas nenit 7 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Për sa më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.11/2026

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së ankuesve M.M-H;
- Inspektoratit Qendror të Punës: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të NJBNJ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.